



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/ 02-11552/23
Kaçanik, 30.05.2023

Në mbështetje të nenit 12. 2(d), 17 (f) dhe (p) të Ligjit Nr. 03 L-040 për Vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të nenit 53 pika 3 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/21 Qershor 2016) të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01 Nr.07-104/02-11552/23 arsyetuar nga DSHPE të datës 16.05.2023, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 maj 2023, merr këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 01 Nr.104/02-7676/22 TË DATËS 31.03.2022 PËR DHËNIEN NË MENAXHIM TË PËRKOHSHËM, PARKINGET NË PRONËSI TË KOMUNËS, NDËRMARRJES PUBLIKE KRM "PASTËRTIA" SH.A. NJËSIA NË KAÇANIK

1. Me këtë Vendim SHFUQIZOHET Vendimi i Kuvendit të Komunës 01 Nr.104/02-7676/22 i datës 31.03.2022 -për dhënie në menaxhim të përkohshëm të parkingjeve në pronësi të Komunës, ndërmarrjes publike "Pastërtia" Sh. A. -Njësia në Kaçanik.
2. Me shfuqizimin e vendimit nga pika 1. e këtij Vendimi, Parkingjet publike RIKTHEHEN në menaxhim të Komunës së Kaçanikut.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do përkujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave (përmes kësaj drejtorie njoftohet mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr.104/02-7676/22
Kaçanik, 31.03.2022

Në mbështetje të nenit 12.2(d) lidhur me nenin 17 të Ligjit nr. 03/L-040-Për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.104/02-7676/22(bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 31 Mars 2022, mori këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN NË MENAXHIM TË PÛRKOHSHËM, PARKINGJET NË PRONËSI TË
KOMUNËS, NDËRMARRJES PUBLIKE KRM "PASTËRTIA " SH.A-NJËSIA NË
KAÇANIK

1. Me këtë Vendim, ipen në menaxhim të përkohshëm, parkingjet publike në pronësi të komunës, Ndërmarrjes publike komunale KRM "Pastërtia" sh.a-njësia në Kaçanik.
2. KRM "Pastërtia" sh.a-njësia në Kaçanik do t'i mirëmbajë dhe inkasoj mjetet që gjenerohen nga vend-parkingjet e komunës.
3. Mjetet e inkasuar do të shfrytëzohen nga KRM "Pastërtia"-njësia në Kaçanik, e njëjta do t'i përdorë për nevojat e funksionimit të kompanisë.
4. Tarifat e shfrytëzimit të vend-parkingjeve caktohen në bazë të Rregullores për Taksa komunale.
5. KRM "Pastërtia" sh.a-njësia në Kaçanik në kundërvlerë të këtij aktiviteti do t'i mirëmbajë hapësirat publike (bulevardin "Ismajl Raka", shëtitoret përgjatë lumit Nerodime, Parkun e Qytetit dhe hapësira tjera sipas marrëveshjes me komunën).
6. Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë mes komunës dhe KRM "Pastërtia" sh.a-njësia në Kaçanik do të precizohen përmes një marrëveshje "në shtëpi" (in house) e rregulluar konform ligjeve në fuqi.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.
8. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante), Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

